

C.nr.101/2013

GJYKATA THEMLORE PRISHTINE, DEGA NE LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Isa Gashi, me pjesmarrjen e procesmbajtëses Makfirete Zhinipotoku, në çështjen kontestimore të paditësit A. P. nga fshati T., kundër të paditures Komuna e Lipjanit- drejtorija e arsimit, të cilin me autorizim e përfaqson F. M., për pagesen e pagave, vlera e kontestit 1.295,40.-€, ne seancën per shqyrtim kryesore, publike dhe gojore, të mbajtur në prani te te autorizuarve te paleve ndergjyqsore, me dt. 25.02.2014, muarr këtë.

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkespadia e precizuar e paditësit A. P. nga fshati T., si e **BAZUAR** dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Lipjanit-drejtorija e arsimit, që paditësit të ia paguaj shumën prej 1.295,40-€, në emër të pagave të pa paguara, per punet dhe detyrat e punes teknik-zoo teknik në SHML “A. G.” në L., për periodën *data...*, e deri më *data...*, me kamatë vjetore prej 3.5%,sipas shkallës së kamatës që pagaujn bankat për mjete të deponuara më tepër se një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga *data...*, e deri tekpagesa definitive, si dhe shumën prej 40.-€ në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dorzimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunëshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, në padi dhe në seancat gjyqsore, ka deklaruar se ka lidhur kontratë pune me të paditurën me dt. *data...*, për punët dhe detyrat e punës teknik-zoo tekniksë në SHML “A. G.” në L., në kohëzgjatje prej gjashtë muajve, duke filluar nga *data...*, e deri me *data...*, për pagën mujore në lartësi prej 215.90.-€, dhe gjatë kësaj periode i ka përmbushur obligimet kontraktuese ndaj të paditurës, ndërsa e paditura për punën e kryer me kontratë pune, paditësit nuk ia ka shpërblyer pagat mujore gjatë kohëzgjatjes së kontraës së punës. Në seancën për shqyrtim kryesore, paditësi e ka precizuar lartësin e kërkespadis, duke kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurën, që për punët e kryer gjatë kohëzgjatjes së kontratës së punës, prej dt. *data...*, e deri me *data...*, të ja paguaj shumën prej 1.295,40.-€, në emër të pagave të papaguara, me kamatë vjetore prej 3.5%, duke filluar nga *data data...*, e deri tek pagesa definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kerkuar.

E autorizuar e te paditures, ne te pergjegjur ne padi dhe ne seancat gjyqsore, deklaroi se parimisht e konteston kërkespadin e paditësit si të pabazuar, duke theksuar se paditësit nuk iu kan paguar pagat sipas kontratës së punës në shumë prej 1.295,40.-€, për arsye se e paditura nuk ka pasë mjete financiare për të ia paguar pagat, për punët dhe detyrat e punës së kryera në bazë të kontratës së punës, dhe se e paditura në momentin që të disponon me mjete financiare, ka gadishmëri ta përmbushë obligimin ndaj paditësit për periodën kontestuese. I ka propozuar gjykates ta refuzon ne tersi kerkespadin si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore, gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqsore, administroi provat me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr. *numri...*të dt. *data...*, specifikacionit të punës së kryer nga punëmarrësi, të lëshuar nga e paditura me *data...*, dhe pas vlersimit me kujdes të secilës provë veq e veq dhe të gjithave së bashku konform nenit 8 të LPK-ës, gjykata gjeti se kërkespadia e precizuar e paditësit, për kompensimin e pagave, është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërsi.

Nga kontrata e punës nr. *nurmi...* e lidhur me dt. *data...*, vërtetohet se paditësi tek e paditura ka themeluar mardhënje pune në kohë të caktuar, për periodën prej *data...*, e deri me *data...*, në vendin e punës teknik-zooteknik në SHML “A. G.” në Lipjan, për pagën bazë mujore prej 215.90.-€.

Nga specifikacioni i punës së kryer nga punëmarrësi A. P. e tani paditësi, e lëshuar nga e paditura me dt. *data...*, vërtetohet se paditësit e paditura për punën e kryer, sipas kontratës së punës së mësipërme, i ka mbetur borgj për shumën prej 1.295.40.-€, faktë ky i cili nuk është kontestues në mes palëve ndërgjyqsore.

Nga keto prova të administruara, e të cilave gjykatat ua falin në tërësi besimin, nga se deri në perfundimin e kontestit me asgjë nuk u vun në dyshim dhe e plotësosnin njera tjetren, dhe fakteve të pakontestueshme në mes palëve, gjykata vërtetoi se paditësi tek e paditura ka kryer punët dhe detyrat e punës teknik-zooteknik në SHML “A. G.” në L., për periodën prej *data...* e deri me *data...* sipas kontratës së punës të lidhur me punëdhësin e tani të paditurën, dhe se paditura edhe për kunders faktit se paditësi i ka permbushur detyrat e punës sipas kontratës, e paditura nuk ia ka paguar pagat sipas kontratës së punës për periodën prej *data...* e deri me datën *data...* në shumë prej 1.295,40.-€.

Me dispozitën e nenit 55.1 të ligjit të punës nr.03/L-212 të shpallur me dt. 01.11.2010, Gazeta Zyrtare 90/01.12.2010, i punsuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe aktin e mbrendëshëm të punëdhësit.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata zbaton dispozitat e lartpërmendura të ligjit të punës, dhe gjeti se kërkespadija e paditësit për pagimin e pagave për periodën kontestuese, që ka punuar tek e paditura, si punor teknik-zooteknik, për periodën kontestuese, është e bazuar, për qka edhe e aprovoj në tërësi kërkespadin e precizuar të paditësit.

Vendimin për kamaten, si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 382 të LMD-es (Nr.04/L-077).

Gjykata i vlersoi edhe thenjet e palës së paditur, se e paditura nuk ka pasë mjete financiare për me i a paguar paditësit pagat për punën e kryer, por sipas gjykatës këto kundërshtime janë të parandësishme për vendosjen ndryshe nga që ka vendosë gjykata, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se e paditura me rastin e lidhjes së kontratës me paditësin, është dashur ti siguroj mjetet me të cilat do ti permbush obligimet e marrura me kontratë, për pagesën e pagave paditësit për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës për të cilat ka lidhur kontratë, dhe faktin se nuk kanë mjete financiare nuk e liron nga detyrimi të paditurën që të permbush obligimet sipas kontratës së lidhur me paditësin.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës, gjykata e muarr duke u bazuar në nenin 452 par 1 dhe 2 të LPK-ës, dhe me që paditësi ka pasë sukses në procedurë, gjykata ja njohu shpenzimet për taksë për padi në shumë prej 20-€ dhe për taksë për aktgjykim në shumë prej 20.-€, në shumë të tërësishme prej 40,00-€.

Nga të theksuarat me lartë u vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË LIPJAN
C.nr.101/2013, me dt.25.02.2014.

GJYKATËSI
 Isa Gashi

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakanaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë, në afat prej 7 dite nga dita e dorzimit të aktgjykimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila ushtrohet nëpërmes të kësajë gjykate.